



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD**

Numri i lëndës: 2022:142070

Datë: 01.08.2022

Numri i dokumentit: 03286980

**CPK.1/20**  
**P.nr.480/18**

**GJYKATA THEMELORE N GJILAN – Dega në Novobërdë, Departamenti i Prgjithshëm**, përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Sulejman Rexhepi çështjen përmbartimore të kreditorit K. K. për F. me E. E. Sh.a (... ) me seli në Prishtinë, kundër debitorit L. A. G. nga fsh. S., Komuna e Novobërdës, duke vendosur lidhur me prapsimin të datës 07.12.2018, të debitorit, jashtë seancës më dt.01.08.2022, mori këtë,

**A K T V E N D I M**

**I. P R A N O H E T** pjesërisht si i bazuar prapsimi i datës 12.12.2018, i paraqitur nga debitori L. A. G., kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.480/18 i datës 27.11.2018 dhe shfuqizohet Urdhëri sa i përket shumës së borgjit në lartësi 250.00€.

**II. REFUZOHET** si i pabazuar prapsimi i dates 12.12.2018, i paraqitur nga debitori A. G., kundër Urdhëri Përmbartimor P.nr.480/18 i datës 27.11.2018, i Prmbaruesit Privat S. SH.A. nga Gjilan dhe mbetet në fuqi Urdhëri, sa i përket shumës së borgjit në lartësi 257.67€.

**III.** Në rast të ushtrimit të ankesës, kundër këtij aktvendimi **OBLIGOHET** debitori që të deponojë shumën e të hollave në lartësi prej 257.67 €, në emër të garancisë duke u bazuar në nenin 78 të LPP-së.

Nëse debitori dështon ta paguaj shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorzuar fare në gjykatë.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesit Privat, Sefer SH. Arifi nga Gjilani me Urdhërin Përmbartimor P.nr.480/18 të dates 27.11.2018, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori K. K. për F. me E. E. Sh .a (...) me seli në Prishtinë, kundër debitorit L.- A. G., lidhur me pëmbushjen e borgjit në lartësi prej 507,67 € me kamat ligjore 8% nga dita e kalimit te afatit per pagese, deri ne pagesen definitive, në bazë të dokumentit përmbartimor –dokumentit të besueshëm Ekstrakti nga librat afarist, DGL.nr.9...386, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Ndaj Urdhërit Prmbarimor, debitori L. A. G. nga fsh. S., më dt. 07.12.2018, ka ushtruar prapsim ne zyren e permbaruesit Privat Sefer Arifi, duke theksuar se Propozimi per Përmbarrim është bërë me date 26.11.2018, në zyren e Permbaruesit Privat Sefer Arifi , me pretendimin, se vlera totale e borxhit tim ndaj kesaj kompanije me nr. unik te konsumataorit –DGL9...386, është gjithsejt 507.67€, ndërsa pas shqyrtimit të këtij propozimi Përmbarruesit Privat Sefer Arifi e lejon përmbarrimin e propozuar dhe me date 27.11.2018, lëshon Urdhër për Përmbarrim e që është në kundërshtim me gjendjen faktike, sepse unë me date 24.11.2018, kam bere pagesen e borxhit ne vlere prej 250 euro dhe vlera e borxhit tim kishte mbetur edhe 257.67€, ne vlerë totale e që është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe në fund i ka propozuar gjykates me anë të vendimit gjyqësor ta refuzoj Urdhërin Përmbarrimor.

Kreditori pas pranimit të prapsimit në afatin ligjor me datë 14.12.2018, ka ushtruar pergjegje ne prapsim duke e kundërshtuar Urdhërin Përmbarrimor me të cilin thekson se me dt.24.11.2018, ka bërë pagese ne shumë prej 250 € dhe borxhin e ka zvogluar, andaj bazuar në nenin 71 paragrafi 1.1 të LPP-së, ky prtendim nuk qëndron sepse propozimi për përmbarrim është i përmbarrueshëm dhe i është bashkangjit dokumenti autentik –Ekstraktet nga librat afarist, i cili njihet si dokument i besueshëm, sipas nenit 29 paragrafi 1.2, të LPP-së, ku thuhet “se ekstratet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e sherbimeve komunale dhe paragrafin 1.3 që ceken edhe „faturat dhe propozimi për përmbarrim është ngritur në bazë te Ekstraktit nga librat afariste ku debitori i ka borxh kreditorit ne shume prej 507.67€. Ndaj debitorit është ngritur propozimi për përmbarrim që është në harmoni me ligjin dhe se debitori nuk ka afruar as një provë që është në kundërshtim me ligjin e procedures Permbarimore .duke u bazuar ne nenin 71 dhe si i till duhet te refuzohet dhe propozojm të mbetet ne fuqi Urdhëri i Përmbarruesit Privat per caktimin e permbarimit P.nr.i dt.23.02.2018.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe duke marrë për bazë rekomandimet e Gjykates së Apelit, konstatoi se prapësimi i debitorit A. G. pjesërisht është i bazuar, sepse i njëjti ka bërë pagesë të shumës së borgjit në lartësi prej 250 € me datën 24.11.2018 andaj gjykata vendosi si në dispozitivin –I- të Këtij Akvendimi.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se prapësimi i debitorit A. G. është i pabazuar, në shumë e borgjit 257€, pasi që i njëjti nuk gjen mbështetje në shkaqet e prapësimt sipas nenit 71 të LPP-së , sepse Ekstrakti nga librat afarist, DGL.nr.9..5386 në emër të debitorit, në bazë të së cilave është lejuar përmbarrimi, është dokument përmbarrimor - titull ekzekutiv, ose ka tipare të përmbarrueshmërisë, konform nenit 29 paragrafi 1.2 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitivin –II- të këtij akvendimi.

Nga të cekurat e mësiprme e në pajtim me nenin 29, 71,72, 73 dhe 78 të LPP-s, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjyqtari**  
**Gazmend Ajvazi**

**KSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtin, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykats Themelore në Gjilan-Dega Novobërdë.

Numri i lëndës: 2022:142070  
Datë: 01.08.2022  
Numri i dokumentit: 03286980